



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosovo
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KËSHILLI KOMUNAL PËR SIGURI NË BASHKËSI

PROCESVERBAL

Mbajtur më 27 mars 2023

Mbledhja u mbajt në sallën e mbledhjeve të Kuvendit dhe filloi në orën 10:05

Mbledhjen e hapi dhe e kryesozi z. Shpejtim Bulliqi, Kryetar i Komunës.

Në mbledhje ishte e pranishëm znj. Marigona Lahu, Nënkryetare e Komunës dhe anëtarët e KKSBB-së: z.Nijazi Jashari, Komandant i Stacionit të Policisë; z.Enver Rama, përfaqësues i komunitetit rom; znj.Sevdije Mustafa, përfaqësuese e komunitetit egjiptian; z.Xhafer Ademi, kryesues i Komitetit për Komunitete dhe përfaqësues i komunitetit rom; znj.Naime Podvorica, zyrtare për Barazi Gjinore; z.Avni Fetahu, Drejtësor i Drejtorisë së Arsimit; z. Nazif Sheqa, kryetar i Këshillit të Prindërve të Arsimit–Podujevë; z.Qefser Behrami, përfaqësues i Këshillit Lokal për Siguri Publike–Kërpimeh; z.Nuhi Selimi, përfaqësues i Këshillit Lokal për Siguri Publike-Orllan; z.Liman Zeqiri, përfaqësues i Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim dhe z.Shemsi Jashari, përfaqësues i OJQ-ve, mediave lokale, komunitetit të biznesit dhe komunitetit të personave me nevoja të veçanta.

Ndërsa munguan: z. Mensur Hoti, përfaqësues i Këshillit të Bashkësisë Islame; z.Shekfi Selmani, përfaqësues i Kishës Protestante-Podujevë; z.Edolind Vishaj, përfaqësues i FSK-së; z.Rizah Muçolli, kryesues i Ekipit Veprues për Siguri në Bashkësi dhe z.Bahri Selimi, përfaqësues i Emergjencave Civile-Drejtësor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit.

Me këtë u konstatua se ekziston kuorumi.

Në mbledhje ishin të pranishëm edhe: Përfaqësuesi i KFOR-it-Oliver Izma, znj. Ilirianë Bunjaku, përfaqësuese e FSK-së (në zëvendësim të z. Edolind Vishaj).

z. Shpejtim Bulliqi, Kryetar i Komunës, të respektuar anëtarë të Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi, më lejoni të hapi mbledhjen e KKSBB-së.

Materialet për mbledhje konsideroj se i keni marrë të gjithë me kohë, a ka ndonjë vërejtje apo plotësim lidhur me rendin e ditës.

Rendi i Ditës

U miratua njëzëri.

1. Shqyrtimi dhe miratimi i ekstraktit të procesverbalit nga mbledhja e mbajtur më 05 dhjetor 2022

U miratua njëzëri

2. Raporti i Policisë së Kosovës për gjendjen e sigurisë në komunë

- Informatë nga përfaqësuesi i KFOR-i për sigurinë në komunë
- Informatë nga përfaqësuesi i FSK-së për sigurinë në komunë

z. Shpejtim Bulliqi, Kryetar i Komunës, fillimi siht falën e ka Komandanti i Stacionit të Policisë z. Nijazi Jashari.

z. Nijazi Jashari, theksoi, do të mundohem në pika të shkurtra të paraqes Raportin e Stacionit Policor Podujevë për vitin 2022. Fillimi siht dua të flas për një rast të vrasjes që ka ndodhur në fshatin Dumnicë, ku rasti është në hetime dhe ende nuk dihet shkaku, as gjëzhojat nuk janë gjetur në vend të ngjarjes, presim informacion nga njësia e hetimeve.

Nënvizoi, në përgjithësi situata e sigurisë në Komunën tonë vazhdon të jetë e qetë.

Sa i përket Raportit dua të paraqes në pika të shkurtra rastet e raportuara dhe të dhënët tjera statistikore. Gjatë kësaj periudhe niveli i veprave penale, krimive të rënda apo të organizuar mbetet në nivel të ulët dhe pa ndikim në situatën e përgjithshme të sigurisë në Komunë.

Gjatë kësaj periudhe kohore nuk ka pas tensione politike, sociale religjioze etj. përveç një rasti në fshatin Lupç kur është rrahur hoxha, por edhe në fshatrat Halabak dhe Bellopojë, por që kanë qenë të menaxhueshme. Krimi të rënda në rrethin tonë të përgjegjësisë nuk ka pasur, megjithatë mund të thuhet se nuk jemi imun ndaj dukurive negative. Si krim i organizuar mund ta quajmë një rast që ka ndodhur përfajde. Sikurse jeni në dijeni jemi në menaxhim sa i përket aspektit të sigurisë të sipërafares më të madhe territoriale në raport me komunat tjera të Republikës së Kosovës. Lidhur me raportin do ju njoftojë në pika të shkurtra. Stacioni Policor sa i përket sektorit të operativës ka qenë i angazhuar në zbatimin e 92 planeve operative, ka asistuar në realizimin e punëve dhe aktiviteteve të ndryshme në 697 raste të institucioneve dhe subjekteve të ndryshme publike, ka realizuar 1565 patrullime në këmbë dhe 3137 pika kontrolli të veturave. Sa i përket urdhëresave të gjykatave ka trajtuar dhe realizuar 1084 të tilla, ka bërë ndalimin e 240 personave, ndërsa arreste shtëpiake 76. Stacioni Policor gjithashtu gjatë kësaj periudhe raportuese ka realizuar projekte në kuadër të strategjisë së PUI dhe PB, duke specifikuar fushatat; - Festo me zemër jo me armë, - Shenjat e hershme të radikalizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm, - Lajmëro Policinë, ti nuk ke kohë përdrogë ke një jetë përfshirë jetuar, - "Ec me këmbët e tyre" (Bashkëpunim me OJQ) etj. Sa i përket aksidenteve të trafikut 281 kanë qenë me dëme materiale, 53 raste me lëndime. Ndaj kundërvajtësve në trafik janë shqiptuar 9725 tiketa, ku ishte një numër më i madh krahasuar me ato në vitin 2021 ku ishin 7184 tiketa. Në zyrën e SIPK-së janë evidentuar 4746 aplikime përfshirë verifikim të së kaluarës kriminale, ndërsa përdokumente të humbura kanë aplikuar 1995. Gjatë kësaj periudhe raportuese Zyra përfshirë administrimin e lejeve të armëve ka lëshuar 164 leje. Krahasuar me vitin 2021 janë hapur 180 raste më pak, përkatësisht në vitin 2021 janë hapur 1484, ndërsa në vitin 2022 janë hapur gjithsejtë 1304 raste. Kur jemi te veprat penale kundër jetës dhe trupit kemi 3 vrasje, 5 vrasje në tentativë dhe 11 raste vdekje të dyshimitë/ hetim mbi vdekjen. Në kategorinë e veprave penale kundër integritetit seksual është 1 rast dhunimi dhe 5 raste të sulmit seksual. Në veprat penale kundër narkotikëve kemi 34 raste të këtyre veprave. Vepra penale kundër ekonomisë i kemi 28 raste të evidentuara sipas raportit në fjalë. Në kategorinë e veprave penale kundër pasurisë janë 449 raste të këtyre veprave, prej tyre; vjedhje 494; vjedhje të rënda 159; vjedhje të rënda në tentativë 47; vjedhje grabitqare 1; grabitje 1 dhe asgjësim apo dëmtim i pasurisë 52 raste. Në grupimin e veprave penale kundër martesës dhe familjes janë të evidentuara dhe trajtuar 85 raste, prej tyre 77 raste të dhunës në familje, 6 raste të keqtrajtimit apo braktisje të fëmijëve, 2 raste të hyrjes në bashkësi jashtëmartesore me persona nën moshën 16 vjeç. Në kuadër të veprave penale kundër mjesdit kemi 8 raste. Në kategorinë e veprave penale kundër sigurisë së përgjithshme të njerëzve dhe pasurisë janë 24 raste; 20 vepra shkaktim i rrezikut të përgjithshëm; 2 asgjësim apo dëmtim i

instalimeve publike dhe 2 vepra penale të tjera. Te kategoria e veprave penale të armë mbajtjes kemi 106 raste të armëmbajtjes pa leje, 19 raste të përdorimit të armëve apo mjetit të rrezikshëm, armë të konfiskuara 54, municion i konfiskuar 738. Vepra penale kundër administraimit të drejtësisë dhe administratës publike kemi 8 raste. Në kategorinë e veprave penale kundër rendit publik 17 raste. Pengim i zyrtarit publik në kryerjen e detyrës zyrtare 0 raste, sulm i personit zyrtar në kryerjen e detyrës zyrtare 11 dhe të tjera 6 raste.

Në kategorinë e veprave të pazbuluara gjatë vitit 2022 janë 382 raste.

z. Shpejtim Bulliqi, Kryetar i Komunës, falënderoj Komandantin e Stacionit policor për këto informacione të paraqitura e që janë të dobishme për ne. Në vazhdim fjalën e ka përfaqësuesi i KFOR-it, e pastaj përfaqësuesi i FSK-së.

Përfaqësuesi i KFOR-it, theksoi, ju falënderojmë për ftesën, unë jam togeri i klasës së parë me pozitën komandant i njësisë për monitorim. Dua të theksoj se mandati i KFOR-it qëndron i njëjtë, nuk ka ndryshuar dhe është për të ofruar një ambient të sigurt. KFOR-i është duke kryer detyrat me njësitet patrulluese por edhe me monitoruese apo vëzhguese sikurse jemi ne. Kemi takime të rregullta me institucionet komunale që merren me çështjen e sigurisë. Sa i përket monitorimit dhe vëzhgimit të gjendjes mund të ndodh që të kemi patrullime dhe vëzhgojmë gjendjen dhe i raportojmë Zyrës së Komandantit të KFOR-it. Pjesë e angazhimit dhe punës tonë ka qenë edhe takimi i inxhinierit nga forcat amerikane sa i përket digave si ndihmesë për këtë, ku para një muaji kemi pas takim me të. Kjo është pjesë e angazhimit tonë që të jemi sa më afér komunave, e në këtë rast Komunës së Podujevës. Nga ana jonë por gjithashtu edhe nga ana e ushtaraku amerikan, i cili ka shprehë gatishmëri, që në javët në vijim të kemi edhe një takim të gjendjes së sigurisë sa i përket digës por edhe të ambientit përreth për të ofruar ndonjë ndihmesë në planin e sigurisë. Për momentin nuk kemi vërejtur ndonjë indikacion që do të ndikojë në gjendjen e sigurisë në komunën tonë, ndërsa nga ana jonë nuk do të mungojë gatishmëria për bashkëpunim.

z. Shpejtim Bulliqi, Kryetar i Komunës, falënderojmë përfaqësuesin e KFOR-it për këto informata, në vazhdim fjalën ia kalojmë përfaqësuesit të FSK-së, e që në takimin e sotëm kemi znj. Liliana Bunjaku.

z. Liliana Bunjaku, theksoi, unë jam togere Lilianë Bunjaku, shërbej në FSK, për çështjet civile, sa për njoftim tash e tutje do të jem pjesë e KKSB-së në Komunën e Podujevës. Sa i përket gjendjes së sigurisë, sipas informatave që kemi, ajo vlerësohet e qetë dhe stabile. Sa i përket aktiviteteve që ka FSK, gjatë kësaj periudhe nuk ka pasur, mirëpo në rast se do të ketë sigurisht se do të njoftoheni me kohë në mënyrë që mos të shqetësohen qytetarët e Komunës së Podujevës. Ne jemi të hapur ndaj kërkesave të juaja si Komunë dhe të lirë për kryerjen e aktiviteteve të përbashkëta që mund të kemi.

z. Shpejtim Bulliqi, Kryetar i Komunës, falënderojmë togeren e FSK-së për informatën e dhënë. Në vijim hapim debatin rreth kësaj pike të rendit të ditës.

z. Nuhi Selimi, theksoi, desha të ndërlidhem me çështjen e sigurisë që ka të bëjë me Nënstacionin e Policisë në fshatin Orllan. Sikurse jeni të njoftuar edhe ju në mbledhjen e fundit me datë 05 dhjetor 2022 e kam ngritur të njëjtën çështje, Nënstacioni i Policisë ka mbetur vetëm me një komandant dhe dy policë për të mbuluar terrenin prej 19 fshatrave të asaj zone. Pyetja është se a ka ndonjë risi, ndonjë kërkesë apo pritet ndonjë zgjidhje të problemit, pasi që po vjen edhe sezoni veror ku do të ketë edhe gravitim më të madh të vizitorëve. Është shqetësim edhe i banorëve të asaj pjese për mungesën e zyrtarëve policor. Ata dy policë janë statik, vetëm bëjnë ndërrimin dhe ruajnë Nënstacionin e Policisë, ndërsa për të operuar në terren është problem. Duke qenë se ka rekrutim të

zyrtarëve të rindj policor, atëherë shtrohet pyetje pse nga ta nuk parashihet edhe një numër i tyre të shërbejë për atë zonë. Deri vonë në atë pjesë kanë qenë të angazhuar së paku 10 policë, ndërsa tani kemi vetëm dy policë dhe kjo shihet si problem. Mendova se komandanti këtë çështje do ta theksojë në Raportin e paraqitur, por sigurisht ka harruar.

z. Qefser Behrami, theksoi, kam një pyetje për Komandantin e Stacionit Policor, a ka ndonjë plan të asgjësimit apo diçka tjetër lidhur me qentë endacak. Para ca dite, më datën 17 të këtij muaji qentë kanë sulmuar dy nxënës, por për fat të mirë qëllova pran dhe u dola në ndihmë dhe për këtë rast kam njoftuar edhe Komandantin e Stacionit të Policisë. Pra desha të theksoj se çështja e qenve endacak po vazhdon të mbetet shumë problematike në atë zonë.

z. Shpejtim Bulliqi, Kryetar i Komunës, theksoi, desha të informojë parafolësin se çështja e cekur për qentë endacak nuk është çështje e Policisë, por e Komunës. Nuk kemi të drejtë asgjësimin e qenve, sepse kjo çështje është e rregulluar me rregullativë ligjore për mbrojtjen e kafshëve dhe ne jemi të obliguar ta respektojmë. Për çdo vit jemi duke shpenzuar shuma të larta të mjeteve buxhetore në funksion të trajtimit të qenve endacak, por fatkeqësisht numri i tyre është relativisht i madh dhe kemi vështirësi në menaxhimin e situatës. Përveç kësaj është një punë që është bukur vështirë të menaxhohet, sepse sa shohim se largohet një numër i madh i tyre përmes formave të trajtimit, prapë shohim që rritet numri i tyre, e gjithashtu dyshohet se ka lëvizje prej lokalitetave në lokalitete kohë pas kohe, pra mund të thuhet se mbetet si çështje mjart problematike. Andaj desha të theksoj që të mos angazhohet Policia sepse kjo nuk është punë e tyre. Ne si autoritet komunal jemi duke punuar në këtë aspekt për të bërë një zgjidhje dhe tani jemi në proces të nënshkrimit të një kontrate të re për trajtim të qenve endacak. Vitin e kaluar kemi pas një kontratë dhe është trajtuar një numër shumë i madh i qenve, megjithatë shohim se prapë kemi telashe, përfshirë edhe këtu brenda në qytet. Qentë sigurisht lëvizin në lokacione ku edhe gjejnë ushqim. Prandaj është detyrë e jona të kujdesemi për këtë çështje, sepse siguria e nxënësve dhe fëmijëve tonë është prioritet. Duhet shikuar nëse ata fëmijë i plotësojnë kriteret për t'u transportuar sepse ne do ta sigurojmë transportin. Dua të them se duhet të punojmë të gjithë bashkërisht për tejkalimin e kësaj situate sepse nuk është një punë e lehtë për t'u realizuar.

z. Shemsi Jashari, theksoi, duke iu referuar raportit të punës së Policisë për vitin e kaluar u veçua se ka shtim të numrit të rasteve për përdorimin e narkotikëve apo që ndërlidhen me narkotik. Duke qenë në dijeni se numri i përdoruesve është i koncentruar te të rintjtë desha të pyes se a ka ndonjë plan bashkë me Drejtorinë për Arsim të bëhet diçka në kuptimin e një fushatë vetëdijësuese, ose evidentim të atyre lokacioneve që njihen si pika të zeza në bazë të raporteve të rasteve që ato shkolla ku mund të janë cak i atyre që shpërndajnë substancat narkotike të bëhet diçka në drejtim si masa parandaluese. Jemi të vetëdijshëm se është problem dhe nuk ka mundësi të eliminohen të gjitha, por me siguri do të kishte mundësi të bëhet diçka në këtë drejtim, çoftë në fushatë informuese me pjesëmarrje direkte duke mbajtur ligjërata nëpër shkolla, pastaj edhe stafin mësimdhënës për ta informuar në detaje se si zhvillohet ajo dukuri dhe cilat janë masat për parandalim apo me ndonjë fushatë përmes mediave ose broshurave.

z. Shpejtim Bulliqi, Kryetar i Komunës, meqë nuk ka pyetje tjera lidhur me shqetësimet e paraqitura fjalën ia kaloj Komandantit të Stacionit Policor z. Nijazi Jashari.

z. Nijazi Jashari, theksoi, lidhur me diskutimin e z. Qefser Behrami për qentë endacak, kemi rast kur një familje ka thirrur policin dhe ky është detyruar të përdorë armën për shkak të rrezikut aty për aty që ka ndodhë. Për këtë është hartuar një mori dokumentesh për të arsyetuar të shtënë. Sa i përket qenve endacak në rrugë ka rregulla dhe procedura

që duhet zbatuar dhe kjo dukuri nuk është e shprehur vetëm në Komunën e Podujevës. Sa i përket diskutimit të z. Nuhi Selimit, çështjen e Nënstacionit policor veç se e kemi diskutuar, ka ndërruar struktura dhe akti është nënshkruar nga Ministri dhe Drejtori i Përgjithshëm i Policisë para disa ditësh. Unë nuk jam në dijeni se a e kanë paraparë në strukturën e re rajonin e Orllanit dhe si do të jetë. Pra struktura e re organizative në Policinë e Kosovës është bërë. Realisht ne kemi vështirësi në këtë aspekt sepse detyrohemë të dërgojmë polic në rajonin e Orllanit. Aktin e strukturës organizative të policisë ende nuk e kemi pranuar. Si do të funksionojë ajo pjesë ende nuk jam në dijeni dhe nuk varet nga ne. Letrën për shqetësimet e juaja e kam dërguar në qendër. Çështja e përdorimit të drogave të cilën e potencoi z. Shemsi Jashari është bërë dukuri shqetësuese. Në fshatin Gllamnik në një shtëpi janë gjetur rreth një kg drogë dhe ka pas të arrestuar. Ky aksion ka rezultuar në bazë të informatës. Në bashkëpunim me shkolla kemi bërë fushatë dhe kemi mbajtur ligjërata në bashkëpunim me Drejtorinë e Arsimit, kemi ndarë fletushka, lapsa, kimik me mbishkrim *stop drogë*. Ne jemi në dijeni të disa lokaliteteve dhe kemi bërë kontroll të lokaleve pasi që ka dyshime që përdoren substancat narkotike por ne nuk kemi hasur. Edhe unë pajtoj se gjenerata e të rinjve nuk janë duke qëndruar mirë në këtë aspekt.

z. Shpejtum Bulliqi, Kryetar i Komunës, theksoi, falënderojmë Komandantin e Stacionit Policor për këto përgjigje. Unë mendoj se për komuniteti i fshatit Orllan ka nevojë për Nënstacionin policor atje, sepse ai komunitet veç se është mësuar me prezencën e policisë atje dhe tani më është pak e ndjeshme të mbetet pa polic atje, sepse edhe ashtu është afër brezit kufitar dhe do të ishte mirë ai nënstacion policor të jetë funksional. Se çfarë janë planet për atë nuk jam në dijeni, mirëpo do të ishte mirë nga ana e Komandantit të Policisë të paraqitet si brengë e atij komuniteti. Sa i përket çështjes së mbajtjes së kurseve dhe seminareve është mirë shoqëria civile të involvohet këtu, sepse edhe juve z. Shemsi Jashari keni eksperiençë në projekte të kësaj natyre, dhe sigurisht ndoshta do të mund të jeni përfitues edhe të ndonjë fondacioni e që mund të realizohet edhe nëpër shkolla. Kjo do të na ndihmonte edhe neve, Drejtorinë e Arsimit dhe Stacionin Policor dhe besoj se Stacioni policor është i gatshëm të involvohet me ekspert të kësaj fushe. Është vërtetë për shqetësim situata sepse sipas informatave që vijnë tregojnë se është në rritje numri i rasteve të përdorimit të substancave narkotike, se a janë shpërndarë apo përdorues është problem për t'i konstatuar këto për vet faktin që kjo qarkullon nëpër qytet dhe lokale të ndryshme. Fatmirësisht është mirë që kjo nuk është duke qarkulluar nëpër shkolla, megjithatë mbetet prapë i njëjtë shqetësim sepse fëmijët dalin prej shkollës dhe kalojnë një pjesë të kohës, në rrugë dhe lokale të ndryshme. Unë inkurajoj Drejtorinë e Arsimit por edhe juve si OJQ, por edhe ne kemi gatishmërinë e involvimit në këtë proces. Qëllimi është që të jemi sa më afër fëmijëve dhe për të diskutuar për këto probleme, sepse kjo dukuri është shumë e rrezikshme për të ardhmen e të rinjve, prandaj besoj se këtu duhet të kemi të gjithë kujdes. Ajo që kisha kërkuar këtu është bashkëpunim më i ngushë i drejtoreve të shkollave me Policinë e Kosovës se një bashkëpunim i ngushtë mënjanon shumë defekte dhe lëshime që mund të ndodhin atje. Ne i kemi disa informacione të fundit që në shkollën "Shaban Shala" kanë ndodhë disa gjëra jo të mira. Unë inkurajoj që Drejtoria e Arsimit së bashku me Drejtorinë e shkollës të kryej punën e vet konformë rregullativës ligjore në fuqi, por natyrisht edhe Policinë që të bashkëpunojë sa më shumë me drejtorë të shkollave në mënyrë që dukuri të tilla devijonte të mos na paraqiten në shkolla tona.

z. Shemsi Jashari, theksoi, po flasim për një çështje që drejtpërdrejtë prekë në siguri, e që në këtë rast pjesë më e ndjeshme e familjes tonë janë fëmijët. Është përgjegjësi e

institucioneve që kanë plane dhe strategji që ti qasen kësaj teme. Sa i përket OJQ-ve dhe aktivitetave që ato mund të bëjnë, ato mund të jenë partnerë dhe ndihmues në atë proces por nuk e kanë mandatin kryesor për ta trajtuar si temë. Ne si organizatë nuk kemi dashur të kemi qasje në fonde të Komunës për arsyen se merremi me monitorim, andaj nuk kemi dashur të përzihemë në atë pjesë, kemi dashur të ruajmë pavarësinë tonë, por organizatët e shoqërisë civile që veprojnë në Komunën e Podujevës dhe buxheti që ndahet për subvencionimin e aktivitetave të shoqërisë civile, e që ka mundësi me u orientua edhe në këtë çështje, të ndahet si kriter dhe një thirrje të jetë e definuar për ato organizata që bëjnë aktivitete për sensibilizimin e të rinjve, për pasojat dhe dëmin që mund të jetë nëse ata nuk janë të kujdeshshëm mjaftueshëm. Drejtoria e Arsimit, Policia dhe ne çfarë kemi mundësi për të bërë do të ishte mirë të mendojmë për qasje të këtij problemi, sepse ky problem nuk është vetëm i Komunës apo i Policisë, është një institucion shumë i rëndësishëm sikurse është këshilli i prindërve i cili mund të jetë shumë aktiv në këtë aspekt. Deri në takimin e radhës Drejtoria e Arsimit do të kishte mundur të dal me një draft të strategjisë, për të paraparë se çka ne mund të bëjmë, për të dhënë kontributin tonë si institacione, për të marrë aktivitete konkrete, në drejtim të paktën të parandalimit apo zvogëlimit të mundësive të démtimit të fëmijëve.

z. Shpejtim Bulliqi, Kryetar i Komunës, theksoi, besoj se këtu mund të bashkëpunojmë të gjithë bashkë dhe çdo njëri nga këndi ynë të japim kontributin dhe kjo është e nevojshme, sepse një institucion i vetëm nuk mund të ia del kësaj dukurie, e cila fatkeqësisht është goxha e përhapur dhe është duke shkuar në tendencë të tilla. Besoj se Drejtoria e Arsimit do të merret më seriozisht me këtë çështje, por edhe ne do të kemi parasysh që eventualisht edhe të destinojmë fonde. Tashmë vetëm sa më informuan se veçse është hapur thirrja publike për financimin e projekteve dhe programeve të OJQ-ve dhe besoj se këtu do t'i japim një prioritet atyre subjekteve të cilat do të merren me këtë problematikë.

z. Nuhi Selimi, meqë u theksua se komuniteti i fshatit Orllan është mësuar me prezencën e zyrtarëve policorë, kjo nuk është çështje e dëshirave të qytetarëve, por është obligim i pushtetit që të ketë si pikë të sigurisë në atë pjesë, pasi që është edhe zonë kufitare. Në atë zonë janë 19 fshatra, e po ashtu edhe burgu i sigurisë së lartë bënë pjesë në atë zonë të sigurisë. Pra nuk është çështje dëshirash por është obligim dhe domosdoshmëri që të ofrohet siguri. Ne si komunitet kemi respekt si dhe bashkëpunim të mirë me ata zyrtarë policorë.

z. Shpejtim Bulliqi, Kryetar i Komunës, gjithashtu theksova pikërisht atë që theksoi parafolësi në diskutim e tij, sa i përket çështjes së sigurisë në zonën e fshatit Orllan. Potencova që ai komunitet atje ka pas gjithherë nënstacionin e Policisë dhe në këtë aspekt edhe është mësuar me këtë dhe se ka nevojë për prezencën e zyrtarëve policorë. Besoj se Komandanti i Stacionit të Policisë do të merret me këtë çështje dhe shpresojmë ta kemi një ekip të zyrtarëve policorë atje, sepse ka nevojë.

z. Avni Fetahu, theksoi, vetëm desha të ju njoftojë lidhur me shqetësimin e z. Shemsi Jashari. Ne si DKA kemi një plan të punës dhe atë të publikuar në ueb faqen e Komunës ku parashihen aktivitetet me Stacionin Policorë të Komunës së Podujevës, për çka edhe jemi falenderues, sepse nuk ka muaj që nuk mbahen takime në nivel shkolle. Me iniciativë të Komandantit kanë ardhur edhe nga Nivelii qendror javën e kaluar dhe ky bashkëpunim me nivelin qendror do të vazhdojë dhe në këtë rast ju inkurajojmë edhe ju dhe secilin që mund të jap kontributin në sensibilizimin e këtyre dukurive negative që janë në shoqërinë tonë në përgjithësi, e në veçanti në shkolla. Nga një bashkëpunim i mirë dhe nga policët civil të angazhuar nëpër shkolla kemi një gjendje pak më të mirë,

por normal që ka edhe aktivitete jo të mira që ndodhin, sikurse ndodhin edhe në tërë Kosovën.

z. Shpejtim Bulliqi, Kryetar i Komunës, theksoi, si duket e azhurnuam andaj edhe e përmbyllim këtë pikë të rendit të ditës.

3. Miratimi i Planit të Punës së KKSBB-së për vitin 2023

z. Shpejtim Bulliqi, Kryetar i Komunës, theksoi propozimi i planit të punës së KKSBB-së është i hartuar nga ekipi i cili është formuar në mbledhjen e fundit të KKSBB-së. Para jush keni propozimin e planit të hartuar me kalendarin e aktiviteteve të rregullta që planifikohen të realizohen nga KKSSB. Këtë propozim plan e vë në diskutim, nëse eventualisht keni ndonjë sugjerim apo plotësim nga ana e juaj mund ta merrni fjalën. Besoj se bashkërisht do t'ia dalim për realizimin e të gjitha këtyre aktiviteteve.

Tani e tutje më lejoni që udhëheqjen të ia kalojë nënkyretares së Komunës pasi që më doli një angazhim në kuadër të punëve që nuk mund ta shtyjë.

znj. Marigona Lahu, Nënkyretare e Komunës, theksoi, fjalën rreth propozim planit të punës së KKSBB-së ia kalojmë z. Shemsi Jashari pasi që ka qenë edhe kryesues i Ekipit.

z. Shemsi Jashari, theksoi, në pajtim me vendimin e fundit për themelin e grupit punues për hartimin e planit të punës së KKSBB-së për vitin 2023, ne kemi draftuar një plan të punës i cili është shumë ngashëm me planin e punës që ka qenë për vitin 2022, e arsyeha kryesore ka qenë që gjatë vitit 2022 KKSBB mund të thuhet se nuk ka kryer shumicën e aktiviteteve të planikuara. Ky plan i punës është i dizajnuar që t'i jap përgjigje nevojave që lidhen me aspektin e sigurisë. Gjatë vitit 2022 ka qenë si kërkosë drejtar ndaj drejtitorit i cili është përgjegjës për këtë pjesë që ta bëjë publik Planin e Reagimit Emergjent dhe një gjë e tillë nuk ka ndodhë. Pra ne nuk shohim një plan të tillë, nëse ka ndonjë plan e që e din vetëm Drejtori atëherë është jofunksional dhe nuk i shërben askujt, kështu që e shfrytëzoj rastin dhe e parashtrojë si kërkosë që të bëhet publik, të dimë cili është ky plan dhe kur është i përditësuar kohën e fundit. Ngjarjet e fundit nga vërshimet tregojnë që një plan është i domosdoshëm, sepse plani i jep një adresim edhe kësaj çështjeje. Ndër tjera shtoi, flasim për koordinimin ndërinstitucional, koordinimin me akterët publik dhe qytetarë, dmth janë përcaktuar objektivat të cilat duhet të arrihen gjatë vitit 2023, janë shpalosë veprimet, është bërë ndërlidhja e aktorëve institucional dhe publik që duhet të përfshihen për realizimin e këtyre objektivave përmes aktiviteteve dhe veprimeve të caktuara. Është pëershruar ndërlidhja me strategjitetë të cilat e obligojnë ndërmarrjen e veprimeve të caktuara dhe kalendarit mujor se kur do të duhej të realizohen këto veprime. Ndër tjera theksoi, te vlerësimi i pikave kritike të mjedisit deri në muajin tetor kam menduar që ta kemi një plan të reagimit emergjent, e nëse ekziston një i tillë, e që ne në fakt nuk jemi në dijeni atëherë ai duhet të përditësohet me të dhënat e fundit, por flasim në aspektin statistikor, numri i banorëve, infrastruktura, objektet publike, e të gjitha këto janë pjesë dhe elemente të rëndësishme që e bëjnë një plan të zbatueshëm ose jo. Është menduar që deri në fund të vitit në muajin nëntor ta kemi një testim të reagimit për raste emergjente ku do të involvoheshin akterët të cilët janë përgjegjës për implementim, e në këtë rast Policia, Zjarrfikësit, shërbimet mjekësore dhe akterët tjerë që mund të jenë pjesë në zbatimin e këtij plani, e krejt kjo me qëllim që përvëç aspektit teorik, që e kemi apo se kemi një dokument, të jemi në dijeni se sa është funksional. Është menduar të ketë një punëtori mes akterëve institucional dhe publik për të hartuar agjendën e përbashkët të planit të përbashkët për vitin 2024, e kjo për faktin që është viti i dytë sepse në vitin 2022 dhe 2023 veç po hyjmë në muajin prill pa filluar pa asnjë plan të punës e do të duhej që muaji janar të na gjente me një plan pune. Është

dashur që muajin dhjetor të hartoher një plan dhe të caktohen aktivitetet dhe të fillohet me implementimin e tyre në muajin janar. Sipas Udhëzimit përkatës për punën e KKSBS-së duhet mbajtur së paku gjashtë takime, e në këtë rast vitin e kaluar kemi pas vetëm katër takime dhe kemi filluar me punë në mes të vitit dhe kjo ka ndikuar që asnje prej atyre aktivitetave të planifikuara jashtë raportimeve të rregullta të mos realizohen, e që në këtë vit do të duhej ta kemi parasysh këtë. Pra kjo ishte në pika të shkurtra çka është menduar të përfshihet në planin e punës.

z. Nijazi Jashari, foli për procesin e përgatitjes së draft Planit të punës. Nënvizoi, punën dhe angazhimin e z. Shemsi Jashari rrëth përgatitjes së draft planit.

z. Avni Fetahu, desha të falënderoj z. Shemsi Jashari për punën rrëth draftimit të Planit. Unë do t'i potencoja dy sugjerime, të cilat edhe i kam potencuar dhe janë më shumë të natyrës organizative, te çështja e informatës mbi gjendjen e pyjeve dhe kur diskutohet rrëth ambientit kemi diskutuar që nëse është moti i mirë do të ishte mirë të dalim edhe në natyrë për mbajtjen e takimeve, sikurse i mbajnë edhe në vende evropiane, e kjo jep një imazh të mirë në aspektin e ruajtjes së ambientit.

z. Marigona Lahu, Nënkyetare e Komunës, për mbajtjen e takimeve kemi sallën e Kuvendit, por mund të shfrytëzojmë edhe hapësira tjera në Komunë, ndërsa nëse jeni për ne mund të vendosim për mbajtjen e takimeve edhe në ndonjë ambient në natyrë.

z. Shemsi Jashari, theksoi, vitin e kaluar por edhe këtë vit gjatë punës së grupit punues për çështje të planit, koordinatori i KKSBS-së, në këtë rast z. Bahri Selimi po është shumë i zënë për t'u marrë me punë të KKSBS-së. Mendoj se ky Këshill është shumë i rëndësishëm. Kur flasim për sektorin e sigurisë për shkak se involvon persona si bartës të përgjegjësive për sigurinë sikurse është komandanti i Stacionit të Policisë, përfaqësuesi i KFOR-it, FSK-së dhe përfaqësues tjerë të institucioneve këtu, do të ishte mirë ta diskutojmë te pika të ndryshme, nëse drejtori është aq i zënë dhe s'ka kohë të merret me KKSBS-në, të gjendet një zgjidhje dhe kjo përgjegjësi t'i kalojë dikujt tjetër që mund të merret me këtë punë, për shkak se është edhe jo shumë respekt për anëtarët e këtij Këshilli që drejtori të jetë vetëm figurativisht. Është përgatitur komplet ky plan i punës dhe nuk kemi asnje reagim nga ana e tij, për të shtuar apo hequr diçka pasi që ai edhe ka informata brenda përgjegjësisë që ka. Mendoj se për të qenë funksional ky Këshill është dashur së pari koordinatori të jetë ai më i interesuari, sepse ne jemi anëtar dhe kemi rolin tonë dhe mund të japim kontributin tonë, por për të shtyrë proceset përpëra dhe për të implementuar këtë agjentë është ai, sepse ai merret edhe me aspektin protokollar se ku do të mbahen takimet, përndryshe unë jam shumë kundër që ky Këshill në këtë përbërje ta ketë vetëm rolin e informimit, sepse për të informuar Komandanti i Stacionit të Policisë mund ta bëjë publik raportin e punës dhe t'ua dërgojë akterëve dhe ne s'kemi nevojë fare për tu takuar. Fakti që kemi mundësi për të diskutuar temat dhe jemi në dijeni që Drejtori, në këtë rast koordinatori i KKSBS-së ka shqetësim, probleme dhe telashe në kryerjen e punëve si në aspektin logistik, kufizime në burime njerëzore etj. mendoj se Këshilli është i themeluar pikërisht për të diskutuar dhe për të parë se çfarë mund të bëjmë më mirë. Pra është një propozim për të rishqyrtuar çështjen e përgjegjësive të koordinatorit, përballë obligimeve që ai ka dhe që nuk mund të jap kontributin në KKSBS.

z. Marigona Lahu, Nënkyetare e Komunës, theksoi, sikurse theksoi parafolësi Drejtoria e Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit është një drejtori e cila ka një volum shumë të madh të punëve gjë që realisht ia pamundëson ndoshta Drejtorit që të jetë më shumë aktiv edhe në KKSBS. Këtë shqetësim do ta përcjell sepse unë nuk jam anëtarë e KKSBS, mirëpo në mungesë të Kryetarit të Komunës jam e obliguar të kryesojë

mbledhjet. Nëse nuk keni diçka tjetër rrëth draft planit të punës së KKSBB-së, atëherë të njëjtin e vejmë në votim.

Konstatim:

Propozimi i Planit të punës së KKSBB-së për vitin 2023 aprovohet nga KKSBB dhe i procedohet Kuvendit për shqyrtim dhe miratim.

z. Shemsi Jashari, theksoi, si grup punues kemi pas për detyrë edhe hartimin e Informatës së KKSBB-së për punët dhe aktivitetet në vitin 2022. Unë kam punuar edhe në përgatitjen e informatës mirëpo e njëjtë është dërguar me vonesë nga ana ime te shërbimi komunal, andaj edhe kjo ka qenë arsyaja pse nuk ka qenë pjesë e agjendës në takimin e sotëm. Mendoj se të njëjtën do ta kemi për diskutim në takimin e radhës së KKSBB-së.

z.nj. Marigona Lahu, Nënkyetare e Komunës, theksoi, meqë këtë pikë e përfundua, kalojmë në pikën e radhës.

5. Të ndryshme


Nuk pat diskutime

z.nj. Marigona Lahu, Nënkyetare e Komunës, nëse nuk ka të interesuar rrëth kësaj pike atëherë e përmbylli takimin, juve ju falënderoj për pjesëmarrje dhe kontributin e dhënë. Shihemi në takimin e radhës.

Mbledhja përfundoi në orën 11:25

Procesverbalin e mbajti

Sabedin Namani


Nr. prot.02-060/04-0022688/23

Podujevë, datë:27.03.2023



**Kryetari i Komunes
Shpejtum Bulliqi**